



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:069483

Datë: 05.11.2021

Numri i dokumentit: 02366822

**P.nr.10/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtarja **Diana Sina**, me zyrtaren ligjore Kaltrina Halilaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit – personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, të akuzuarit – personit përgjegjës të personit juridik P. E. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe të akuzuarit – personit përgjegjës të personit juridik D. Q. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.1717/2018, të datës 24.12.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën 28.10.2021, në prani të Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, mbrojtësit të personit juridik Granit Vokshi, avokat në Prishtinë si dhe të akuzuarve - personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., personi përgjegjës i personit juridik P. E. nga Prishtina dhe personi përgjegjës i personit juridik D. Q. nga Gjakova, me datë 01.11.2021 mori dhe shpalli, ndërsa me datën 05.11. 2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**1. PERSONI JURIDIK “. . .”** me seli në Prishtinë me përfaqësues të autorizuar **H. Z.**, nga i ati A., e ëma E., e vajzërisë D., data e lindjes . . . në Vlorë, Republika e Shqipërisë, tani me banim në Prishtinë, në rrugën “. . .”, pallati . . ., hyrja . . ., i pamartuar, ka të kryer nivelin Master në Biznes, me profesion ekonomist – menaxher, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, me numër personal . . .

**2. Personi përgjegjës i personit juridik P. E.**, nga i ati V., e ëma L., e vajzërisë G., data e lindjes . . . në Glllogoc, Komuna e Drenasit, tani me banim në Prishtinë, në rrugën “. . .”, SU2/8, numër 20, i martuar, atë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

**3. Personi përgjegjës i personit juridik D. Q.**, nga i ati M., e ëma S., e vajzërisë H., data e lindjes , , , në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “. . .”, numër . . ., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

**J a n ë f a j t o r :**

**I. Personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z.:**

**Sepse:** nga fillimi i muajit Prill të vitit 2018 deri me datën 01.11.2018 në Gjakovë, më saktësisht në rrugën “. . .” numër . . ., “. . .” në cilësinë e personit juridik me seli në Prishtinë, me personin përgjegjës P. E. me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe personin tjetër, hap një filialë të veprimtarisë së lojërave të fatit në Gjakovë në adresën e lartcekur, për të cilën nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent dhe të njëjtën e ushtron veprimtarinë pa licencë dhe leje paraprake për lejimin e një veprimtarie të tillë.

**- Me çka ka kryer veprën penale, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së.**

**II. Personi përgjegjës i personit juridik P. E. nga Prishtina,**

**Sepse:** nga fillimi i muajit Prill të vitit 2018 deri me datën 01.11.2018 në Gjakovë, më saktësisht në rrugën “. . .” numër . . ., i pandehuri si person përgjegjës i personit juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe personin tjetër, mundëson hapjen e një filiale të veprimtarisë së lojërave të fatit në Gjakovë në adresën e lartcekur, për të cilën nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, në atë mënyrë që i akuzuari në bashkëpunim me të akuzuarin D. Q.n, janë marrë vesh që të hapin një pikë të biznesit të veprimtarisë së lojërave të fatit në Gjakovë në rrugën “. . .” numër . . . dhe të njëjtën e ushtrojnë pa licencë dhe leje paraprake për lejimin e një veprimtarie të tillë.

**- Me çka ka kryer veprën penale, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së.**

**III. Personi përgjegjës i personit juridik D. Q. nga Gjakova,**

**Sepse:** me datën 01.11.2018 në Gjakovë, në rrugën “. . .” numër . . ., saktësisht në njësinë e kompanisë “. . .”, në lokalin “. . .”, me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm për vete, organizon, merr pjesë dhe ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove ose të lojërave të fatit për të cilën nuk ka qenë dhënë më parë licenca apo leja organit kompetent, në atë mënyrë që i akuzuari ushtron veprimtarinë e lojërave të fatit pa poseduar leje përkatëse të lëshuar nga organi kompetent komunal, ashtu që gjatë kontrollit të organizuar nga inspektorët e Administrata Tatimore e Kosovës dhe Policia e Kosovës, në njësinë e kompanisë i akuzuari është hasur duke ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit pa licencë të organit kompetent.

**- Me çka ka kryer veprën penale, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17 par.1, 41, 42,43, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, neni 300 par. 2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, neni 5, 8, 9, 10 i Ligjit Nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, si dhe neni 365 të KPP-së:

**G J Y K O N**

**I.** Të akuzuarin : Personin juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar  
**H. Z.:**

**DËNIM ME GJOBË** në shumën prej **1,000.00-€ (njëmijë euro)**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II.** Të akuzuarin – personin përgjegjës të personit juridik **P. E.** nga Prishtina:

**DËNIM ME KUSHT** - Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

**III.** Të akuzuarin – Personin përgjegjës të personit juridik **D. Q.** nga Gjakova,

**DËNIM ME KUSHT** - Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara Administrata Tatimore e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohen të akuzuarit - Personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., personi përgjegjës i personit juridik P. E. nga Prishtina dhe personi përgjegjës i personit juridik D. Q. nga Gjakova, që secili veç e veç të i paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **30.00.-€** dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.00.-€**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### ***1. Ecuria e procedurës penale***

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1717/2018 të datës 24.12.2018, kundër të akuzuarit – personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhazit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, të akuzuarit – personit përgjegjës të personit juridik P. E. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhazit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe të akuzuarit – personit përgjegjës të personit juridik D. Q. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhazit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtit të i shpallë fajtor dhe të i dënojë sipas ligjit.

I akuzuari – personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., gjatë shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv I. të aktakuzës, ka shtuar se për herë të parë paraqitet në gjykatë për një vepër të kryer penale dhe ka premtuar se do të jetë edhe hera fundit, duke i propozuar gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Mbrojtësi i personit juridik, av. Granit Vokshi, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë, ka konsideruar se i njëjti është i bazuar në dispozitat e KPP-së dhe është bërë pa presion dhe në mënyrë të vullnetshme nga ana e përfaqësuesit të subjektit juridik dhe me rastin e shqiptimit të dënimit i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si parasysh si rrethanë lehtësuese dhe që në përputhje me nenin 75 të KPRK-së të aplikueshëm në momentin kur është kryer vepra penale, gjatë shqiptimit të dënimit të shqiptojë dënim nën minimumin e paraparë për këtë veprë penale.

I akuzuari P. E., si person përgjegjës i personit juridik gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv II. të aktakuzës për të cilën veprë është penduar pa masë, në atë kohë është marrë me këtë veprimtari duke menduar për një jetë më të mirë dhe të mbaj familjen, por pasi ky biznes nuk ka shkuar si duhet, nuk është marrë më me këtë biznes, ka shtuar se është baba i dy fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, për momentin i papunë, si dhe për herë të parë paraqitet në gjykatë për një veprë të kryer penale dhe ka premtuar se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari D. Q. ,si person përgjegjës i personit juridik gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv III. të aktakuzës për të cilën veprë është penduar pa masë, në atë kohë është marrë me këtë veprimtari duke menduar për një jetë më të mirë dhe të mbaj familjen, por pasi ky biznes nuk ka shkuar si duhet, nuk është marrë më me këtë biznes, është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe për herë të parë paraqitet në gjykatë për një veprë të kryer penale dhe ka premtuar se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së përfaqësuesit të autorizuar të personit juridik “. . .” – H. Z., si dhe të personave përgjegjës të personave juridik P. E. dhe D. Q., të cilët pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë të vullnetshme, çka si organ i ndjekjes e ka vlerësuar korrektësinë dhe sinqeritetin e treguar në këtë seancë gjyqësore, njëherit pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës. Njëherit ka përmirësuar kualifikimin juridik për personin përgjegjës të personit juridik P. E., ashtu që duhet të hiqet “lidhur me nenin 40”, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pandryshuar.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilat ngarkohen me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

### 3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykuese ka vërtetuar këto gjendje faktike:

3.1. I akuzuari - personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 40 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

3.2. I akuzuari - personi përgjegjës i personit juridik P. E. nga Prishtina ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

3.3. I akuzuari - personi përgjegjës i personit juridik D. Q. nga Gjakova ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 300 paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm e kryen: *“Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo të lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”* Ndërsa në nenin 40 të KPRK-së është parashikuar përgjegjësia penale e personave juridik, ku theksohet se *“personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer veprën penale duke vepruar në emër të personit juridik brenda autorizimeve të tij, me qëllim të përfitimit të dobisë apo ka shkaktuar dëm për atë person juridik. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe nëse veprimet e personit juridik kanë qenë në kundërshtim me politikat e afarizmit ose me urdhrat e personit juridik.”*

### 5. Vendimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese të akuzuarit - Personin juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., personin përgjegjës të personit juridik P. E. nga Prishtina dhe personin përgjegjës të personit juridik D. Q. nga Gjakova, i ka shpallur fajtorë për veprat penale për të cilat janë ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara në dispozitivin I, II dhe III të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së dhe bazuar në këtë ka vendosur që të akuzuarit të i gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe

lartësisë së dënimit, ku gjykata morri për bazë disa rrethana lehtësuese dhe disa rrethana posaçërisht lehtësuese. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar :

**I.** Për të akuzuarin - personi juridik “. . .” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar H. Z., gjykata mori parasysh faktin se më parë ka qenë i pa dënuar për kryerjen e ndonjë vepra penale, ka pasur qëndrimi tejet korrekt si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale. Si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet. Kështu që duke mos gjetur asnjë rrethanë rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të KPRK-së dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 9 par.1 të Ligjit Nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale kur ka shqiptuar dënimin me gjobë nën kufijtë e përcaktuar me ligj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për veprën penale nga neni 300 par.2 të KPRK-së për të akuzuarin.

**II.** Për të akuzuarin - personi përgjegjës i personit juridik P. E. nga Prishtina, gjykata mori parasysh faktin se është familjar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar më parë për kryerjen e ndonjë vepra penale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, si dhe pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, ndërsa nuk gjeti rrethana rënduese.

**III.** Për të akuzuarin - personi përgjegjës i personit juridik D. Q. nga Gjakova, gjykata mori parasysh faktin se është i papunë i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar më parë për kryerjen e ndonjë vepra penale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, si dhe pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, ndërsa nuk gjeti rrethana rënduese.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi vlerësoi me shumë kujdes të gjitha rrethanat lehtësuese erdhi në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së. Sipas bindjes së gjykatës dënimet e tilla të shqiptuara janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 463 par.1 dhe 2 të KPP-së, gjyqtarja e vetme gjykuese ka vendosur që të dëmtuarën, për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko-civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kësaj kërkesë.

#### 8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 par.3 të KPP-së dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjyqtarja e vetme gjykuese ka vendosur që i akuzuarit t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**P. nr.10/19 më datë 01.11.2021**

**Zyrtarja ligjore,**  
**Kaltrina Halilaj**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.